

V E N D I M
Nr.20, datë 17.5.1996

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, e përbërë nga :

Rustem Gjata,	Kryetar i Gjykatës Kushtetuese	
Hilmi Dakli,	Anëtari	“““
Manol Konomi,	Anëtari	“““
Veli Budo,	Anëtari	“““
Franc Jakova,	Anëtari	“““
Alfred Karamuço,	Anëtari	“““
Zija Vuci,	Anëtar i“““	

me sekretare Arbenka Lalica, në datën 17.5.1996 mori në shqyrtim në seancë gjyqësore me dyer të hapura çështjen Nr.27 Akti, që i përket :

K Ë R K U E S E : PARTIA E DJATHTE DEMOKRATE, e përfaqësuar nga Z. Petrit Kalakulla.

PALË E INTERESUAR : KOMISIONI QENDROR I ZGJEDHJEVE, i përfaqësuar nga Z. Kreshnik Spahiu.

O B J E K T I:

Shfuqizimi i Vendimit nr.474, datë 14.5.1996 të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve

GJYKATA KUSHTETUESE, pasi dëgjoi relacionin përkatës,

V Ë R E N:

Partia e Djathtë Demokrate, me shkresën nr.2/6, datë 4.5.1996 i është drejtuar Komisionit Qendror të Zgjedhjeve duke u ankuar për veprime të parregullta të disa komisioneve të zgjedhjeve të zonave e që sipas saj kanë konsistuar në mospranimin për shqyrtim të dokumenteve të disa kandidatëve për deputetë e mosdhënien e dokumentit të regjistrimit të kandidatit.

Në datën 14.5.1996, Partisë së Djathtë Demokrate i është paraqitur një njoftim që mban numër 474 Protokolli dhe nënshkruar nga kryetari i Komisionit Qendror të Zgjedhjeve, sipas të cilit ankesa nuk është marrë në shqyrtim me arsyetimin se është paraqitur jashtë afateve ligjore.

Ushtrimi i një kompetence të tillë nga ana e kryetarit të Komisionit Qendror të Zgjedhjeve bie ndesh me dispozitat ligjore. Në bazë të shkronjës “c” të nenit 36 të Ligjit nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet në Kuvendin Popullor”, ndryshuar me Ligjin nr.8055, datë 1.2.1996, të drejtën për të shqyrtuar ankimet ndaj akteve dhe veprimeve të paligjshme e të parregullta të komisioneve të zgjedhjeve të zonave, e ka Komisioni Qendror.

Prandaj, është e drejtë dhe detyrë e vetë Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shqyrtojë ankimin e Partisë së Djathtë Demokrate dhe të vendosë sipas dispozitave ligjore.

PËR KËTO ARSYE:

Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë, në mbështetje të nenit 24 pikat 7 e 9 të Ligjit nr.7561, datë 29.4.1992 “Për disa ndryshime e plotësime në Ligjin nr.7491, datë 29.4.1991 “Për dispozitat kryesore kushtetuese” si dhe të nenit 36 të Ligjit Nr.7556, datë 4.2.1992 “Për zgjedhjet e Kuvendit Popullor të Republikës së Shqipërisë”, ndryshuar me Ligjin Nr.8055, datë 1.2.1996, me shumicë votash,

V E N D O S I:

Detyrimin e Komisionit Qendror të Zgjedhjeve të shqyrtojë ankimin e Partisë së Djathtë Demokrate të paraqitur në datën 4.5.1996.

Ky vendim është i formës së prerë dhe hyn në fuqi menjëherë.

U shpall sot më datë 17.5.1996

